

Microsoft Albania sh.p.k.
Raporti i Audituesit të Pavarur dhe
Pasqyrat Financiare më dhe
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

Përmbajtja

	Faqe
Raporti i Audituesit të Pavarur	
Pasqyra e pozicionit financiar	4
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	5
Pasqyra e ndryshimeve në kapital	6
Pasqyra e flukseve të parasë	7
Shënimet e pasqyrave financiare	8 – 42

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Aksionarëve dhe Drejtuesve të Microsoft Albania Sh.p.k,

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Microsoft Albania SHPK ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2019 dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2019 si dhe performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF-të").

Bazat për opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrafin e emërtuar "Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare" të këtij raporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës së Kontabilistëve Profesionistë i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombëtare të Etikës ("BKSNE") dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si edhe, kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit.

Përgjegjësitë e drejtuesit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, si edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtuesit, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare të veçanta pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve. Në përgatitjen e pasqyrave financiare drejtuesit është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënimet shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Shoqërisë, dhe të përdorë parimin kontabël të vijimësisë, përveç rasteve kur drejtuesit ka ose për qëllim të likudojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveçse sa më lart. Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare (vazhdim)

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë procesit së auditimit. Gjithashtu, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, hartojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie material, si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të sistemeve të kontroleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të përshtatshme me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e sistemeve të kontroleve të brendshme të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga drejtuesit.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtuesit, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vemendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidences së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërpreje të aftësisë së Shoqërisë për vazhduar në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet thelbësore në një mënyrë që arrin prezantimin e drejtë.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare (vazhdim)

Ne komunikojmë me palët e ngarkuara me qeverisjen e Shoqërisë, ku përveçse çështjeve të tjera, komunikojmë edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në sistemin e kontrollit të brendshëm që është identifikur gjatë auditimit tonë.

Deloitte Audit Albania shpk

Deloitte Audit Albania sh.p.k

Rr. Faik Konica, Ndërtesa nr. 6, Hyrja nr. 7, 1010

Tirana, Albania

Numri Unik i Identifikimit të Subjektit (NUIS): L41709002H

Enida Cara
Auditues ligjor
Partner Angazhim



20 maj 2020
Tiranë, Shqipëri

Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

	Shënime	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
Aktivet			
Aktivet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	6	12,656	18,043
E drejta e përdorimit të aktiveve	7	12,488	-
Aktive tatimore të shtyra	8	633	1,025
Totali i aktiveve afatgjata		25,777	19,068
Aktive afatshkurtra			
Parapagime dhe shpenzime të periudhave të ardhme	9	1,741	2,054
Aktive kontraktuale	10	-	27,591
Llogari të arkëtueshme tregtare	11	59,450	17,004
Aktive tatimore	12	5,805	5,756
Paraja dhe ekuivalentet e saj	13	51,332	54,575
Totali i aktiveve afatshkurtra		118,328	106,980
Totali i aktiveve		144,105	126,048
Kapitali dhe detyrimet			
Kapitali aksionar	14	100	100
Fitimi i pashpërndarë		118,814	85,802
Totali i kapitalit		118,914	85,902
Detyrimet afatgjata			
Detyrime afatgjata qiraje	15	8,063	-
Totali i detyrimeve afatgjata		8,063	-
Detyrimet afatshkurter			
Detyrime afatshkurtra qiraje		4,344	-
Detyrime kontraktuale	16	3,558	16,774
Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera	17	143	18,294
Provizione për detyrime tatimore	18	1,854	1,854
Detyrime tatimore	19	7,229	3,224
Totali i detyrimeve afatshkurtra		17,128	40,146
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		144,105	126,048

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm më 20 maj 2020 dhe janë firmosur nga:

Joli Pijaneci
Perfaqësuese Ligjore



Përgatitur nga:

Ernst & Young Albania sh.p.k.



Shënimet shpjeguese në faqet 8 deri 42 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Microsoft Albania sh.p.k.**Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019***(Të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)*

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shitje neto	20	123,261	106,177
Shpenzime personeli	21	(17,480)	(15,095)
Shpenzime të tjera operative	22	(30,225)	(59,842)
Shpenzime amortizimi	6, 7	(10,571)	(7,714)
Fitimi operativ		64,985	23,526
Shpenzime interesi	23	(333)	-
Humbje nga kursi i këmbimit, neto	24	(97)	(35)
Fitimi para tatimit		64,555	23,491
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	25	(10,808)	(4,765)
Fitimi neto për vitin		53,747	18,726
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse		53,747	18,726

Shënimet shpjeguese në faqet 8 deri 42 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Microsoft Albania sh.p.k.

Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

	Kapitali aksionar	Fitimi i pashpërndarë	Totali
Gjendja më 1 janar 2018	100	87,076	87,176
Fitimi neto i vitit 2018	-	18,726	18,726
Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse		18,726	18,726
Dividend i paguar për vitin	-	(20,000)	(20,000)
Gjendja më 31 dhjetor 2018	100	85,802	85,902
Rregullimi i fitimit të pashpërndarë si rrjedhojë e aplikimit të SNRF16 sipas qasjes retrospektive të modifikuar		(735)	(735)
Gjendja më 1 janar 2019	100	85,067	85,167
Fitimi neto i vitit 2019	-	53,747	53,747
Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse	-	53,747	53,747
Dividend i paguar për vitin	-	(20,000)	(20,000)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	100	118,814	118,914

Shënimet shpjeguese në faqet 8 deri 42 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Microsoft Albania sh.p.k.

Pasqyra e flukseve të parasë për vitin e mbyllur më 31dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
AKTIVITETE OPERATIVE		
Fitimi para tatimit	64,555	23,491
Rregullime për:		
Amortizimin, Aktive afatgjata materiale	6	6,288
Amortizimin, Aktive - e Drejtë Përdorimi	7	4,283
		7,714
		-
Flukset e parasë nga aktiviteti operativ përpara ndryshimeve në kapitalin punues	75,126	31,205
<i>Ndryshimi në kapitalin punues</i>		
Rënie në parapagime dhe shpenzime të periudhave të ardhme	313	2,891
Rënie në aktivet kontraktuale	27,591	9,960
Rritje në llogari të arkëtueshme (Rritje) / rënie në aktivet tatimore	(42,446) (49)	(9,688) 368
Rënie / (rritje) në detyrimet kontraktuale	(13,216)	2,955
Rënie në llogaritë e pagueshme dhe detyrime tatimore	(18,403)	(5,276)
Rënie në detyrimet e qirasë	(890)	-
Interesi për detyrimin e qirasë	333	-
Tatimi fitimi i paguar	(6,160)	(5,450)
Flukset e parasë neto nga veprimtaritë operative	22,199	26,965
AKTIVITETE INVESTUESE		
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	(901)	(16,240)
Flukset e parasë neto e përdorur në aktivitetet investuese	(901)	(16,240)
AKTIVITETE FINANCUESE		
Pagesat e principalit të qirasë	(4,541)	-
Divident i paguar	(20,000)	(20,000)
Flukset e parasë neto e përdorur në aktivitetet financuese	(24,541)	(20,000)
Renie neto e parasë	(3,243)	(9,275)
Paraja dhe ekuivalentet e saj në fillim të vitit	54,575	63,850
Paraja dhe ekuivalentet e saj në fund të vitit	51,332	54,575

Shënimet shpjeguese në faqet 8 deri 42 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Microsoft Albania sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur në 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

1. TË PËRGJITHSHME

Microsoft Albania ("Shoqëria") u themelua më 30 qershor 2008 si Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe u regjistrua sipas vendimit të gjykatës në të njëjtën datë, me NIPT K8183001C dhe numër serial certifikate: SN-055925-05-09.

Aksionari i Shoqërisë është Microsoft Corporation, e cila zotëron 100% të aksioneve. Microsoft është një korporatë software-sh me bazë në SHBA, e regjistruar më 22 shtator 1993, me seli në Redmond, Washington.

Microsoft Corporation është entiteti kontrollues i drejtpërdrejtë dhe përfundimtar i Shoqërisë.

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është ofrimi i shërbimeve për zhvillimin e tregut, shërbimet e lokalizimit dhe shërbimet që lidhen me software dhe hardware kompjuterik, përfshirë pa asnjë kufizim, shërbime teknike, trajnime dhe këshillime.

Më 31 dhjetor 2019, Shoqëria ka 1 punonjës (2018: 2). Zyrat e Shoqërisë ndodhen në Rr.Papa "Gjon Pali II", ABA Business Center, Floor 12/5, 1000, Tiranë, Shqipëri, që nga Janari 2018 (adresa e mëparshme ka qenë Rr. "Abdyl Frasheri". P.11/1, EGT Tower 2nd floor, Tiranë, Shqipëri).

Drejtuesit dhe Përfaqësuesit ligjorë më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 janë

Benjamin Owen Orndorff	Administrator
Keith Ranger Dolliver	Administrator
Sokol Vladi	Drejtor i Përgjithshëm deri në 31.10.2019
Ervin Nallbani	Përfaqësues Ligjor deri në 15.02.2020
Joli Pijaneci	Përfaqësues Ligjor nga 15.02.2020 e në vazhdim

2. BAZA E PËRGATITJES

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

2.2 Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazën e kostos historike.

2.3 Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur dhe paraqitur në Lekë Shqiptarë ("LEK"), që është monedha e mjedisit ekonomik parësor në të cilin Shoqëria kryen aktivitetin e saj.

2.4 Përdorimi i vlerësimeve dhe i gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që Drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën këto vlerësime janë rishikuar dhe në periudhat e ardhshme që ndikohen.

Në procesin e aplikimit të politikave kontabël të Shoqërisë, Drejtimi ka bërë gjykimin në vijim, përveç atyre që përfshijnë vlerësime (shih më poshtë), i cili ka efekt më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare:

2. BAZA E PËRGATITJES (VAZHDIM)

2.4 Përdorimi i vlerësimeve dhe i gjykimeve (vazhdim)

Njohja e aktivitetit të shtyrë

Njohja e aktivitetit të shtyrë bazohet në supozimin që ka më shumë mundësi se jo që në të ardhmen të ketë fitime të mjaftueshme të disponueshme, kundrejt të cilave mund të zbriten diferencat e përkohshme të njohura. Pra njohja përfshin gjykim në lidhje me rezultatet e ardhshme të Shoqërisë.

Parimi i vijimësisë

Drejtimi i Shoërisë i ka përgatitur pasqyrat financiare bazuar në parimin e vijimësisë. Në bërjen e këtij vlerësimi, drejtimi ka pasur në konsideratë pozicionin financiar të Shoqërisë, planet e saj biznesore afatshkurtra, mundësinë e fitimit nga veprimtaria operationale dhe aftësinë për të pasur akses në burimet e financimit, si dhe ka analizuar impaktin e krizës financiare së përgjithshme në veprimtarinë e ardhshme ekonomike të Shoqërisë. Gjithashtu drejtimi i Shoqërisë nuk ka dijeni në ekzistencën a pasigurive materiale që mund të hedhin dyshime të qenësishme në mundësinë e Shoqërisë për të vazhduar veprimtarinë ekonomike bazuar në parimin e vijimësisë.

Zhvillimi i shpejtë i epidemisë të Covid-19 dhe impakti i madh social dhe ekonomik i kësaj pandemie në Shqipëri dhe në rang global mund të cojë rishikimin dhe ndryshimin e supozimeve dhe vlerësimeve të drejtimit që mund të sjellin si rrjedhojë rregullime të qenësishme të vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit financiar që vjen. Në këtë fazë, drejtimi i Shoqërisë nuk është në gjendje të vlerësojë me besueshmëri impaktin real pasi zhvillimet po ndodhin dhe evoluojnë ditë pas dite.

Impakti në terma afatgjatë mund të ndikojë negativisht në volumet tregtare, flukset e parasë dhe marzhin e fitimit të operationeve. Sidoqoftë, në datën e raportimit të këtyre pasqyrave financiare Kompania vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohë. Kështu që këto pasqyra financiare janë përgatitur plotësisht mbështetur në parimin e vijimësisë së aktivitetit biznesor.

Treguesi i realizimit të shërbimeve

Njohja e të ardhurave bazohet në treguesin e realizimit të shërbimeve të kryera. Drejtimi kryen vlerësimin e vet se si do të matet puna e realizuar, siguron që puna e kryer të miratohet nga personeli inxhinierik dhe dhe treguesi i realizimit të bazohet në numrin e orëve të punës faktikisht të shpenzuara kundrejt totalit të numrit të orëve të parashikuara për kryerjen e punës. Detajet për matjen e treguesit të realizimit paraqiten më tej në shënimin 3.5 të këtyre pasqyrave financiare.

3. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj regjistrohen me kurset e këmbimit që prevalojnë në datat kur ndodhin transaksionet. Në çdo datë raportimi, zërat monetarë të mbajtur në monedhë të huaj ripërkthehen në Lek me kursin e datës së raportimit. Zërat jo-monetarë të mbajtur në monedhë të huaj të matur me vlerë të drejtë ripërkthehen në LEK me kursin e datës kur është përcaktuar vlera e tyre e drejtë. Zërat jo-monetarë të cilët maten me kosto historike në monedhë të huaj nuk ripërkthehen. Diferencat nga kurset e këmbimit që lindin nga shlyerja e zërave monetarë dhe nga ripërkthimi i zërave monetarë të mbajtura në monedhë të huaj, njihen në pasqyrën e fitim humbje dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse të periudhës.

Kurset e këmbimit në fuqi në fund të vitit midis Lek-ut dhe monedhave të tjera të huaja janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
USD	108.64	107.82
EUR	121.77	123.42

Microsoft Albania sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur në 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

3. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

3.2 Instrumentat financiare

Shoqëria fillimisht njih llogaritë e arkëtueshme dhe depozitat e parave në datën kur ato krijohen. Të gjitha aktivet e tjera financiare (duke përfshirë aktivet e matura me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes) njihen fillimisht në datën e transaksionit në të cilën Shoqëria bëhet palë e kushteve kontraktuale të instrumentit. Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale të fluksve të parasë që i atribuohen aktivitetit në pronësi ju mbaron afati, ose kur Shoqëria transferon të drejtat për të perfutur fluksin monetar kontraktuale që i atribuohen aktivitetit financiar në një transaksion në të cilin Shoqëria transferon thelbesisht të gjitha risqet dhe perfitimet që lidhen me pronësinë mbi aktivin. Aktivitetet dhe detyrimet financiarë kompensohen me njera tjetren dhe shuma neto e tyre paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm dhe vetëm kur Shoqëria ka të drejtë ligjore për të kompensuar shumat me njera tjetren dhe synon të shlyejë detyrimin në baza neto ose të njohe aktivin dhe të shlyejë detyrimin në të njëjtën kohë.

Instrumentat financiarë jo-derivativë të Shoqërisë përbëhen nga llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera, paraja dhe ekuivalentet e saj, llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera pagueshme dhe detyrime.

Paraja dhe ekuivalentet e saj

Paraja dhe ekuivalentet e saj përfshijnë paranë në arkë dhe llogaritë rrjedhëse.

Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht sipas vlerës së drejtë dhe më pas maten me koston e tyre të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv pakësuar për humbjet nga zhvlerësimi.

Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera janë paraqitur në vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me koston e tyre të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Huatë

Huatë njihen fillimisht me vlerën e drejtë, pakësuar për kostot e kryerjes së transaksionit dhe më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e normës së interesit efektiv, ku shpenzimet e interesit njihen sipas bazës së interesit efektiv.

Metoda e normës së interesit efektiv

Metoda e normës së interesit efektiv është një metodë për llogaritjen e koston të amortizuar të një detyrimi financiar dhe për shpërndarjen e shpenzimit të interesit mbi periudhën përkatëse. Norma e interesit efektiv është norma e cila skanton saktësisht pagesat e ardhshme monetare përgjatë periudhës së pritshme të detyrimit financiar, ose, aty ku është e përshtatshme, një periudhë më të shkurtër.

Kontabilizimi për të ardhurat dhe shpenzimet financiare është diskutuar në seksionin 4.7 të përmbledhjes së politikave kryesore kontabël.

3.3 Aktivet afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale maten me koston minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e ndodhura nga zhvlerësimi. Kostoja përfshin shpenzimin që i atribuohet drejtpërdrejt blerjes së aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vete-prodhuara përfshin koston e materialeve të përdorura dhe koston direkte të punës për prodhimin e aktivitetit, çdo kosto tjetër të kryer për ta sjellë aktivin në kushte e duhura që të shfrytëzohet për qëllimin e përcaktuar, kostot e çmontimit dhe largimit të aktivitetit dhe kostot për rikthimin e vendit të instalimit në gjendjen fillestare, si dhe kostot e kapitalizuara të huamarrjes.

Kur pjesë të një elementi të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme ato kapitalizohen si zëra të veçantë (komponentë kryesor) të aktiveve afatgjata materiale. Të ardhurat dhe humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit e një aktiviteti afatgjatë material përcaktohen duke krahasuar të ardhurat nga shitja e aktivitetit afatgjatë material me vlerën e tij kontabël dhe keto të ardhura dhe humbje njihen në vlerë neto në pasqyrën e fitimit humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse.

Microsoft Albania sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur në 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

3. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

3.3 Aktivet afatgjata materiale

(ii) Kostot të mëpasshme

Kostot e zëvendësimit të një pjese të një zwri të aktiveve afatgjata materiale, njihen nw vlerwn kontabwl tw aktivit nw fjalw nëse është e mundshme që përfitime te ardhme ekonomike që i atribuohen asaj pjese tw aktivit do të perftohen nga Shoqëria dhe kostoja e kwrtij zwvendwsimi mund të matet me besueshmwri. Vlera e mbetur e pjesës së zëvendësuar çregjistrohet. Kostot e shërbimeve ditore të mirwmbajtjes sw aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën e fitim humbjes dhe tw ardhurave gjithëpërfshirëse kur ato ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi llogaritet mbi vlerën e amortizueshme, qw është kostoja e një aktivi, apo një vlerë zëvendësuese e koston, minus vlerën e tij të rikuperueshme. Amortizimi njihet në pasqyrën e fitim humbjes dhe tw ardhurave gjithëpërfshirëse ne bazë lineare sipas jetës sw dobishme të vlerësuar të secilit zw të aktiveve afatgjata materiale, duke qenë së kjo metodw e shpwrndarjes sw shpenzimit tw amortizimit reflekton më besnikerisht modelin e pritshëm të konsumimit të përfitimeve të ardhshme ekonomike të trupëzuara në një aktiv. Jeta e dobishme e vlerësuar te aktiveve për periudhën aktuale si dhe për periudhën krahasuese janë si më poshtë:

Kategoritë	Vitet
Pajisje zyre	3
Automjete	3
Mobilje dhe orendi	3
Pajisje dhe programe kompjuterike	1-2
Punime e riparime për ambjentet me qira	5

Shoqëria është palë e një marrëveshje qiraje që në tetor 2017 për ambientet e zyrave të reja me një afat fillestar prej 5 vitesh, e cila mund të zgjatet edhe për një afat tjetër 5 vjecar, nëse palët bien paraprakisht dakord nëpërmjet një marrëveshje me shkrim. Ne daten e fillimit te kontratës së qirasë, Shoqëria ka pritshmeri por nuk është teresisht e sigurte qe do te ushtroje opsionin e rinovimit te kontrates, dhe ne keto kushte Shoqëria e vlerëson jetëgjatësinë e aktivit "Punime permiresuese te ambjenteve me qira" te jete ne bashkerenduar me kohezgjatjen e afatit fillestar te qirase, dmth 5 vite, duke e amortizuar koston e ketyre permiresimeve ne baze lineare përgjatë 5 viteve.

Metodat e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlerat e rikuperueshme (nwse ka) tw aktiveve nw pronwsi tw Shoqërisw, rishikohen nga ajo në fund të çdo viti financiar si dhe bëhen rregullime nëse wshtw e pwrshatshme.

3.4 Zhvlerësimi

Aktivt financiar

Një aktiv financiar që nuk mbahet me vlerën e drejtë përmes fitimit/humbjes, vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna objektive që ka pësuar zhvlerësim. Një aktiv financiar ka pesuar zhvlerësim nëse ka të dhëna objektive të një ngjarje që ka çuar në zhvlerësim të tij pas momentit fillestar të njohjes së aktivit, dhe kjo ngjarje ka efekt negativ në flukset e ardhshme të parasë nga aktivi, të cilat mund të maten me besueshmëri

Humbja nga zhvlerësimi i nje aktivi të mbajtur me kosto të amortizuar llogaritet si diferencë midis vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme monetare që priten të gjenerohen nga ky aktiv financiar të skontuara me normën fillestare të interesit efektiv te aktivit. Humbjet njihen në fitim humbje dhe të ardhurat përmbledhëse dhe regjistrohen në një llogari bilanci që është kundërparti e një llogarie te arkëtueshme. Interesi mbi një aktiv të zhvlerësuar njihet nëpërmjet amortizimit të vlerës së skontuar. Kur një ngjarje pasuese shkakton zvogëlimin e humbjes nga zhvlerësimi, ky zvogëlim i humbjes nga zhvlerësimi rimerret nëpërmjet fitim humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse.

Microsoft Albania sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur në 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

3.4 Zhvlerësimi (vazhdim)

Aktivitet jo-financiare

Vlerat kontabël të aktiveve jo financiare të Shoqërisë rishikohen në datën e raportimit në mënyrë që të përcaktohet nëse ka ndonjë të dhënë për zhvlerësimin. Nëse një e dhënë e tillë ekziston, në këtë rast vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Vlera e rikuperueshme është më e madhja midis vlerës së drejtë pakësuar për kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Për vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e ardhshme të parasë skontoohen me vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit, e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të aktivitetit për të cilin vlerësimet e flukseve të ardhshme të parasë nuk janë rregulluar.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose e njësisë së saj gjeneruese të parasë e kalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve njihen në fitim humbje dhe të ardhurat gjithëpërfshirëse.

3.5 Njohja e të ardhurave

E ardhura është fluksi hyres bruto i përfitimeve ekonomike gjatë periudhës që gjenerohet gjatë aktivitetit normal të Shoqërisë. E ardhura matet me vlerën e drejtë të vlerave të arketuara ose që priten të arkëtohen. E ardhura zvogëlohet për vlerën e kthimeve të vlerësuar të klientëve, rabateve dhe zbritjeve të ngjashme, nëse ka.

E ardhura nga komisionet nga Microsoft Corporation, përfaqëson një burim të brendshëm të të ardhurave me të cilat Microsoft Corporation shperblen filialet vendore të Microsoft për aktivitetet e zhvillimit të tregut, të ardhura keto që njihen mbi bazën e shpenzimeve operative të kryera nga filialet e Microsoft. Qellimi i Microsoft Corporation është që duke i shperblyer me të ardhurat e komisioneve filialet e saj vendore, ato, kanë përveç komisioneve edhe të ardhurat të siguruara nga kryerja e shërbimeve ndaj klienteve pale të treta, do kështu do të kenë një fitim të qendrueshëm dhe do të sigurojnë një mbulim stabil të shpenzimeve totale operative.

Të ardhurat nga shërbimet profesionale teknike Microsoft (MCS) dhe shërbimet mbështetëse Premier ndaj palëve të treta bazuar në kontratat e shërbimeve njihen në bazë të fazës së përfundimit të shërbimeve, e cila matet në bazë të orëve të punës së shpenzuara të konsulentëve dhe kostos së burimeve të kontraktuara teknike dhe njerëzore.

Kur shërbimet janë kryer në një numër të papercaktuar veprimesh përgjatë një periudhe të caktuar kohe, e ardhura njihet në bazë lineare përgjatë periudhës së specifikuar, për atë kohë sa nuk ka evidence se një metodë tjetër e njohjes se të ardhures përfaqëson më mirë fazën e përfundimit.

Aktivitet Kontraktuale

Bazuar në SNRF 15, kur Shoqëria kryen shërbime për klientin e saj, në rastin specifik shërbimet MCS, përpara se klienti të paguajë apo përpara se pagesa të bëhet e detyrueshme, Shoqëria do ta paraqesë shërbimin e kryer si një aktiv kontraktual, duke përjashtuar këtu llogaritë e arkëtueshme tashmë të njohura. Një aktiv kontraktual përbën të drejtën e Shoqërisë për të marrë një pagesë në këmbim të shërbimeve që ajo ka kryer për klientin. Aktivitet kontraktuale të Shoqërisë konsistojnë në të ardhurat e përlogaritura të njohura vetëm për shërbimet e kryera MCS dhe paraqiten si një zë i vecantë në pasqyrën e bilancit në një vlerë të duhur të bazuar mbi numrin e orëve të shpenzuara nga konsulentet e Shoqërisë si dhe të burimeve të kontraktuara teknike dhe njerëzore të kryera për periudhën.

Detyrimet Kontraktuale

Detyrimi kontraktual përfaqëson detyrimin e Shoqërisë për të furnizuar shërbimet ndaj klientëve palë të treta nga të cilët Shoqëria ka marrë një pagesë monetare përpara së Shoqëria të kryejë dhe furnizojë shërbimet tek klientët në fjalë. Detyrimet kontraktuale të Shoqërisë konsistojnë vetëm në të ardhurat e parapaguara për shërbimet PSS, që paraqiten si një zë i vecantë në pasqyrën e bilancit në një vlerë të duhur që bazohet në vlerën e detyrimit kontraktual për të kryer dhe furnizuar shërbimin PSS ndaj klientit.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

3.6 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi për llogaritë nëpër banka si dhe të ardhurat nga kurset e këmbimit, të cilat njihen në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave. Të ardhurat nga interesi njihen në momentin që ato konstatohen duke përdorur metodën e interesit efektiv. Interesi periodik i konstatuar në aktivet financiare njihet në të ardhurat nga interesi.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet për interesa mbi huatë dhe detyrimet mbi qiranë, si dhe humbjet nga kurset e këmbimit. Shpenzimet nga interesi njihen në momentin që ato konstatohen duke përdorur metodën e interesit efektiv. Interesi periodik i konstatuar në detyrimet financiare njihet në shpenzimet e interesit. Fitimet dhe humbjet nga kurset e këmbimit raportohen në bazë neto.

3.7 Të ardhura dhe shpenzime të tjera

Të ardhurat dhe shpenzimet e tjera njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara në momentin që shërbimet janë siguruar.

3.8 Tatimi

Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave dhe përfaqëson shumën e tatimit të pagueshëm të periudhës dhe tatimin e shtyrë.

Tatimi i periudhës është tatimi i pagueshëm i pritshëm mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normat e tatimit të zbatueshme në datën e raportimit, si dhe çdo rregullim mbi tatimin e pagueshëm në lidhje me vitet e mëparshme.

Fitimi i tatueshëm ndryshon nga fitimi neto i paraqitur në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave sepse ai përjashton zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve, të cilat janë të tatueshme ose të zbritshme në vitet e tjera si dhe përjashton zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve, të cilat nuk janë asnjëherë të tatueshme ose të zbritshme.

Tatimi i shtyrë regjistrohet duke përdorur metodën e bilancit dhe llogaritet si tatimi i pritshëm për t'u paguar ose për t'u arkëtuar sipas diferencave të përkohshme midis vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime fiskale.

Vlera e tatimit të shtyrë bazohet në mënyrën e pritshme të realizimit ose shlyerjes së vlerës së mbartur të aktiveve dhe detyrimeve, duke përdorur normat e tatimit të miratuara dhe në fuqi në datën e raportimit. Detyrimet për tatimin e shtyrë njihen për të gjithë diferencën e përkohshme të tatueshme dhe aktivet për tatimin e shtyrë njihen vetëm në masën që është e mundur që fitime të tatueshme të ardhshme do të jenë të disponueshme, kundrejt të cilave mund të aplikohen diferencat e përkohshme të zbritshme.

Aktivitet për tatimin e shtyrë zvogëlohen në masën që nuk është më e mundur që përfitimi i lidhur me to të mund të realizohet.

Tatimi i shtyrë llogaritet me normën e taksës që pritet të aplikohet në periudhën kur detyrimi shlyhet ose kur aktivi realizohet dhe ngarkohet ose kreditohet në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave, me përjashtim kur ai lidhet me zëra të cilët ngarkohen ose kreditohen në zërin e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, në këtë rast tatimi i shtyrë shpërndahet gjithashtu në këtë zë.

3.9 Pagesat e bazuara ne aksione

Shoqëria zbaton SNRF 2 për transaksionet e pagesave të bazuara në aksione me punonjësit e saj. Te gjitha pagesat e bazuara ne aksione jane te shlyera me mjete monetare nga Microsoft Corporation si person juridik dhe punonjesve te Shoqërise. Bazuar ne objektin e zbatimit te SNRF 2, transaksionet e pagesave te bazuara ne aksione dhe te shlyera ne mjete monetare jane ato ne te cilat njesia ekonomike merr sherbime nga punonjesit dhe nje ne kembim nje detyrim ndaj punonjesve, vlera e te cilit matet

Microsoft Albania sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur në 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në '000 Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

3.9 Pagesat e bazuara ne aksione (vazhdim)

me vleren e drejte te aksioneve te njesise ekonomike apo te instrumentave te kapitalit te nje njesie tjetere ekonomike grupit.

Pagesat e bazuara ne aksione per punonjesit maten ne vleren e drejte te aksioneve ne cdo date te raportimit dhe ne momentin e shlyerjes. Detajet ne lidhje me percaktimin e vleres se drejte te transakcioneve te bazuara ne aksione dhe te shlyera ne mjete monetare jane paraqitur ne shenimet shpjeguese te shenimit 27 te ketyre pasqyrave financiare.

3.10 Qiratë

SNRF 16, zëvendëson SNK 17- Qiratë, dhe është i zbatueshëm për periudhat raportuese që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019. Standardi i ri siguron dy metoda tranzicioni për qiramarrësit. Qiramarrësi lejohet të zbatojë standardin:

- në mënyrë retrospektive për secilën periudhë raportimi paraprake të paraqitur sipas SNK 8 (Politikat e Kontabilitetit, Ndryshimet në Vlerësimet e Kontabilitetit dhe Gabimet) - Qasja retrospektive e plotë, ose
- në mënyrë retrospektive, duke paraqitur efektin kumulativ të aplikimit fillestar të SNRF 16 si një rregullim në balancën e fitimit të pashpërndarë në datën e aplikimit fillestar - Qasja retrospektive e modifikuar.

Shoqëria ka zbatuar standartin sipas qasjes retrospektive të modifikuar, e cila lejon matjen e të drejtës së përdorimit të aktivitetit me qira në shumën e barabartë me detyrimin e qirasë të rregulluar nga shuma e çdo pagese të parapaguar ose të akorduar të qirasë që nga dita e tranzicionit. Detyrimi fillestar i qirasë do të llogaritet si vlera aktuale e pagesave të qirasë për qiratë ekzistuese nga data e tranzicionit deri në mbarimin e qirasë.

Për më tepër, drejtimi i Shoqërisë ka zgjedhur të aplikojë disa përjashtime në fazën tranzitore dhe praktika të cialt janë të disponueshme në zbatimin e standardit, të përmendura si më poshtë:

- Një qiramarrës mund të mbështetet në vlerësimin e tij nëse qiraja objekt zbatimi të SNRF 16 është mbivlere (duke zbatuar SNK 37 - Provigjionet, Detyrime dhe Aktive të kushtezuara) menjëherë përpara datës së aplikimit fillestar të SNRF 16 si një opsion alternative i detyrimit për të kryer rivlerësimin nëse ka zhvlerësim të shumës së qirasë. Kështu, Shoqëria vlerësoi se nuk do të kryhet asnjë vlerësim i të drejtës së përdorimit të aktivitetit me qira, për të parë nëse ka ndonjë zhvlerësim në kohën e adoptimit të standardit.
- Kostot fillestare direkte përjashtohen nga matja e aktivitetit të së drejtës së përdorimit në datën e adoptimit.
- Zbatimi i kërkesave për njohjen dhe matjen, sipas SNRF 16, për qiratë e aktiveve "me vlerë të vogël" janë bere rast pas rasti.

Drejtimi i Shoqërisë gjithashtu mori në shqyrtim nëse norma e skontimit duhet të rregullohej për të pasqyruar mjedisin ekonomik dhe monedhën në të cilën mbahet kontrata e qirasë.

Korporata Microsoft (Pronari) dhe filialet e saj, përfshirë Shoqërinë, janë pale të një marrëveshjeje për menaxhimin e centralizuar të mjeteve monetare, me anë të të cilave Microsoft Corporation në mënyrë të rregullt terheq prej filialeve likuiditetin e tepert dhe ju dergon atyre mjete monetare sipas nevojave duke menaxhuar kështu në mënyrë të centralizuar likuiditetin (dmth qe filialet nuk marrin hua lokalisht mjete monetare). Prandaj, drejtimi i Shoqërisë beson se nuk është e përshtatshme të zbatohet një rregullim në normën e skontimit për të pasqyruar mjedisin ekonomik lokal dhe monedhën e raportimit.

4. APLIKIMI I STANDARDEVE TË REJA DHE TË PËRDITËSUARA

4.1 STANDARDET E PUBLIKUAR, POR, ENDE JO EFEKTIVE

Standardet dhe interpretimet e publikuar, por ende jo efektive, deri në datën e nxjerrjes së pasqyrave financiare të shoqërisë janë dhënë më poshtë. Shoqëria synon të miratojë këto standarde, nëse është e aplikueshme, kur ato të hyjnë në fuqi.

SNRF 17 Kontratat e Sigurimeve

Në Maj 2017, BSNK publikoi SNRF 17 Kontratat e Sigurimeve (SNRF 17), një standard i ri kontabël i përgjithshëm për kontratat e sigurimeve që mbulojnë njohjen dhe matjen, paraqitjen dhe zbulimin. Sapo të hyjë në fuqi, SNRF 17 do të zëvendësojë SNRF 4 Kontratat e Sigurimeve (SNRF 4) që është lëshuar në vitin 2005. SNRF 17 zbatohet për të gjitha llojet e kontratave të sigurimit (dmth jetësore, jomateriale, sigurimi i drejtpërdrejtë dhe risigurimi) llojin e subjekteve që i lëshojnë ato, si dhe garancive të caktuara dhe instrumenteve financiare me karakteristika të pjesëmarrjes së lirë.

Do të zbatohen disa përjashtime nga fushëveprimi. Objektivi i përgjithshëm i SNRF 17 është të sigurojë një model të kontabilitetit për kontratat e sigurimit që është më i dobishëm dhe i qëndrueshëm për siguruesit. Në kundërshtim me kërkesat e SNRF 4, të cilat bazohen kryesisht në politikat e mëparshme të kontabilitetit të mëparshëm, SNRF 17 ofron një model gjithëpërfshirës për kontratat e sigurimeve, duke mbuluar të gjitha aspektet përkatëse të kontabilitetit.

Thelbi i SNRF 17 është modeli i përgjithshëm, i plotësuar me:

- Një përshtatje specifike për kontratat me karakteristika të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë (qasja e tarifës së ndryshueshme)

- Një qasje e thjeshtuar (qasja e shpërndarjes së primit) kryesisht për kontratat me afat të shkurtër.

SNRF 17 është efektive për periudhat e raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021, me shifra krahasuese të nevojshme. Aplikimi i hershëm është i lejuar, me kusht që entiteti të zbatojë gjithashtu SNRF 9 dhe SNRF 15 në ose para datës së zbatimit të parë të SNRF 17. Ky standard nuk është i zbatueshëm për Shoqërinë.

Interpretimi i KIRFN 23 Pasiguria per Trajtimin ne lidhje me Tatimin mbi të Ardhurat

Interpretimi trajton kontabilitetin për tatimin mbi të ardhurat kur trajtimet tatimore përfshijnë pasigurinë që ndikon në zbatimin e SNK 12 dhe nuk zbatohet për tatimet ose taksat jashtë fushëveprimit të SNK 12 dhe as nuk përfshin në mënyrë specifike kërkesat që lidhen me interesin dhe penalitetet në lidhje me trajtimin e pasigurt të tatimin.

Interpretimi trajton në mënyrë specifike sa vijon:

- Nëse një entitet i konsideron trajtimet e pasigurta tatimore veç e veç
- Supozimet që një entitet bën në lidhje me ekzaminimin e trajtimeve tatimore nga autoritetet tatimore
- Si një entitet përcakton fitimin e tatueshëm (humbje tatimore), bazat tatimore, humbjet tatimore të papërdorura, kreditë tatimore të papërdorura dhe normat tatimore
- Si një entitet i konsideron ndryshimet në fakte dhe rrethana

